



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



gi
Komuna e Deçanit
Janar 2024


Raporti i Zbatueshmerise se Rekomandimeve të Zyrës Kombetare të Auditimit-ZKA

Opinion I Kualifikuar Për Pasqyrat Financiare Vjetore¹

Ne i kemi auditor pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Deçanit (KD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

¹ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/05/RaportiAuditimit_K_DEC_2022_Shqip.pdf



Nr.	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar për zbatim	Raporti i hapave konkret për zbatim të rekomandimit dhe implementim
1.	Çështja B1 - Mangësi në regjistrimin e pasurive kapitale dhe jo kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe PFV.	Ka filluar regjistrimi dhe verifikimi i të gjithave pasurive komunale	Zyrtari i pasurisë - Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Dhjetor 2023	Janë Marre hapat e duhur pas emërimit të zyrtarit të ri të Pasurive është bërë bartja e shkollës Emdond Hoxha Komune se Junikut, është bërë evidentimi i pronave komunale tani është në tenderim vlerësimi i tyre, është bërë korrigjimi Shkollave e komunës se Deçanit, pajisjeve, dhe veturave zyrtare.
2.	Çështja B2 – Keq klasifikim i shpenzimeve.	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i	Zyrtaret përgjegjës do të marrin veprimet e duhura dhe do të sigurohen që nuk do të përsëriten me rastet e tilla.	Zyra e kryetarit Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Korrik 2023	Shpenzimi i buxhetit nga Komuna e Deçanit këtë vit është bërë sipas planifikimit dhe sipas kategorive

		shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate				ekonomikë të cilave ju takon shpenzimi, ndërsa për Pagesat përmes thesarit nga Vendimet gjyqësore përmbartimore nuk janë ne do ten tone.
3.	Çështja B3 – Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente në PFV.	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve kontigjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.	Krijimi i komisionit përkatës për këtë rekomandim. Analizimi i planit detal për veprim Impelementimi rekomandimit në fjale nga personi i autorizuar dhe përgjegjës.	Zyra e kryetarit Zyra Ligjore Avokati i Komunës	Dhjetor 2023	Zyrtari përgjegjës – avokati i komunës ka filluar të beje implementimin e këtij rekomandimi ku janë evidencuar të gjitha rastet dhe proceset e hapura që kanë të bëjnë me detyrimet kontingjente, pra azhurnimi i listës bëhet në baza javore dhe mendojmë që ky rekomandim nga ZKA është implentuar.
4.	Çështja B4 – Mangësi në shpalosjen e	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet për t'i adresuar shkaqet që kanë	Do të rritet kontrolli i brendshëm –	Administrata komunale, menaxheret e	Shtator 2023	Janë marre masat e nevojshme që mos

	detyrimeve të papaguara në PFV	ndikuar në gabimet e shpalosjeve për detyrimet e papaguara dhe të sigurojë se të gjitha faturat pranohen përmes arkivit të komunës .	Arkiv – zyra e buxhetit.	Kontratave, Drejtoria për Buxhet dhe Financa		te mbetet asnjë faturë nga vitit 2023 pa u shpalos si obligim i pa paguara
5.	Çështja A1 - Mangësi në ekzekutimin e pagesave për subvencione dhe transfere.	Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për tu siguruar që mjetet e paguara për këto qëllime kanë shkuar në destinimin e synuar si dhe të forcojë kontrollet në ekzekutimin e pagesave për tu siguruar se nuk do të përseriten raste të tilla.	Zyrtaret përgjegjës do të marrin veprimet e duhura dhe do të sigurohen që nuk do të përseriten me rastet e tilla.	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Qershor 2023	Pas marrjes së vërejtjeve nga ana e Zyrës kombëtare të auditimit nuk është kryer asnjë pagës nga subvencionet në emër të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta në institucionin tone.
6.	Çështja A2 – Mos aplikimi i drejtë i kushteve ligjore për vlerësimin e tenderëve si jo normalisht të ulët.	Kryetari duhet të shtojë kontrollet në zyrën e prokurimit për të siguruar se stafi i caktuar në menaxhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij.	Do të rritet kontrolli nga ana e zyrës së prokurimit për menaxhim të mirëfilltë sipas Ligjit në procedurat e tenderimeve.	Zyra e prokurimit.	Dhjetor 2023	Janë marre masat e duhura në përmirësimin e këtij rekomandimi
7.	Çështja B5 - Tejkallim i sasive të kontraktuara mbi 30% e lejuar për	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po	Menaxheret e kontratave do të kujdesen që mos të përseriten me tejkallimi i 30% të lejuar për	Zyra e Kryetarit Menaxheret e kontratave, Zyra e Prokurimit.	Tetor 2023	Janë marre veprimet e nevojshme nga menaxheret e kontratave dhe janë zbatuar me

	kontratat publike kornizë.	ashtu duhet të sigurojë se projektet e specifikuar nuk tejkalojnë paramasën e përllogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.	kontratat publike kornize			kujdes kontratat dhe ne vitin 2023 nuk tejkalojnë te 30% te lejuar te kontratave
8.	Çështja B6 - Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MShV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.	Do të merren masat duhura që të zbatohet Ligji dhe rregulloret e nevojshme.	Zyra e Kryetarit, Zyra ligjore	Dhjetor 2023	Kryetari i Komunës ka marrë parasysh rekomandimet e vazhdueshme për këtë rekomandim dhe ka shfuqizuar 70% të marrëveshjeve për shërbime të veçanta pa procedura dhe kanë mbet edhe 25 në fuqi për shkak të mungesës së stafit dhe nevojës për ekspert të lemive të ndryshme
9.	Çështja B7 - Mangësi në shpërndarjen e subvencioneve për organizatat jo qeveritare OJQ	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu, me rastin e	Janë marre masat e duhura që të hapim thirrje publike për mbështetje të OJQ-ve dhe	Zyra e Kryetarit Drejtoria për Buxhet dhe financa	Prill 2023	Me dt. 09.03.2023 kemi bërë hap thirrjen për subvencionimin e OJQ-ve dhe klubeve sportive dhe janë kryer

		ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.	lidhjen e marrëveshjeve.			sipas ligjit dhe rregulloreve ne fuqi
10.	Çështja A3 - Ndarja e bursave në kundërshtim me kushtet e konkursit publik	Kryetari duhet të shtojë kontrollet në procesin e vlerësimit të aplikuesve për ndarjen e subvencioneve komunale për të siguruar se përfitojnë vetëm ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.	Zyrtarët përkatës do ti marrin masat e duhura për implementimin e rekomandimit	Zyra e Kryetarit	Gusht 2023	Kryetari i Komunës ka marrë masat e duhura që ky rekomandim të implementohet
11.	Çështja B8 – Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara nga Thesari.	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Zyrtarët përkatës do ti marrin masat e duhura për implementimin e rekomandimit.	Zyra e kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe financa Dhe Drejtorit tjera	Shtator – Dhjetor 2023	Edhe pse komuna shpreh gatishmërinë e pagesave me kohe dhe bëjmë planifikim të mirëfillta buxhetor prap kemi mungese buxhore e cila rezulton si pasoje e tërheqjeve të mjeteve nga procedurat përmbarimore
12.	Çështja B9 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.	Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit. Pastaj të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë	Nga zyrtaret përgjegjës do të verifikohet gjendja faktike dhe të merren masat e duhura në	Zyra e Tatimit ne prone	Dhjetor 2023	ZTP ka marrë masa dhe ka bërë komunikim të vazhdueshëm me Dep. e tatimit ne prone ne MFT per zbatimin e

		në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave.	implementimin e rekomandimit			këtij rekomandimi si dhe komisioni i ankesave ka vepruar ne teren karshi kërkesave te regjistruara ne ZTP
13.	Çështja B10 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve.	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Do të angazhohen zyrtaret përkatës për implementimin e rekomandimit	Zyra e Tatimit ne Prone	Dhjetor 2023	Nuk kemi marr masa ne përmirësimin e këtij rekomandimi
14.	Çështja B11 - Ankesa nga tatimpaguesit për vlerësimin e gabuar të pronave.	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.	Zyrtarët përkatës do ti marrin masat e duhura për implementimin e rekomandimit	Drejtoria për Buxhet dhe financa dhe zyra e Tatimit ne prone	Shtator 2023	Drejtoria për buxhet dhe financa ka marre masat e duhura ne përmirësimin e këtij rekomandimi ne vitin 2023 17 te cilat kane qene kryesisht për fshirje te

						objekteve te rrënuara.
15.	Çështja B12 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare.	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Zyrtarët përgjegjës do të angazhohen për implementimin e rekomandimit	Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Shtator 2023	Kryetari i Komunes e Ka formuar nje komision per vlersimin e pasurive jo financiare dhe eshte bere evidentimi i vlerës monetare te te gjitha pasurive.
16.	Çështja B13- Menaxhimi jo efektiv i llogarive të arkëtueshme	Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Zyrtarët përkatës do të marrin masat e duhura për implementimin e rekomandimit	Drejtoria për Buxhet dhe financa dhe zyra e Tatimit ne prone	Dhjetor 2023	Drejtoria për Buxhet dhe financa dhe Departamenti i Tatimit ne prone ka përgatitur listat dhe ka dërguar letër kujtesa ne muajin Tetor te te gjithë borxhlinjtë.
17.	Çështja B14- Mungesa e planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të NjAB-së	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e	Kryetari do të Marr masat e duhura ne përmirësimin e këtij rekomandimi	Zyra e personelit Zyra e Auditorëve te brendshëm	Dhjetor 2023	Nuk kemi marr veprime ne lidhje me këtë rekomandim

		audituarë për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.				
--	--	---	--	--	--	--

Kryetari i Komunës
Z. Bashkim Ramosaj



Deçan 2023